



PANAIRI KOSOVA

IDE dhe INOVACION

24 – 26 Tetor 2024 Prishtina Mall, Prishtinë

Aplikim për pjesëmarrje

Emër dhe mbiemër:

Roli:

Emri i kompanisë:

Numri Fiskal:

Adresa:

Numri i Telefonit:

Email:

Web:

1. Titulli i aktivitetit: Panairi ndërkombëtar i biznesit
“IDE dhe INOVACION”

2. Organizator: PANAIRI KOSOVA SHPK Rr Ilir Durmishi
1/9 10000 Prishtinë. Kosovë
Phone. +383 48 300 341
Email: panairi@gmail.com, panairi@1kosova.com
Web: <https://panairi.1kosova.com>
(Në vazhdim ORGANIZATORI)

3. Vendi dhe datat e aktivitetit: “IDE dhe |INOVACION”
do të organizohet në Prishtinë, Kosovë, nga data 19 deri

më 24 Tetor 2024 dhe do të qëndrojë i hapur nga ora 9:00-19:00 për vizitorët dhe 8:30-19:30 për ekspozuesit. Administrata e panairit rezervon të drejtën të ndërrojë datat dhe oraret në rast të arsyeve madhore të cilat nuk janë në kontroll të organizatorit. Në këtë rast Organizatori përjashtohet nga çdo detyrim për dëmin e shkaktuar dhe fitimin e munguar.

4. Aplikimi Për të marrë pjesë në panair ekspozuesi hyn në kontratë me shkrim me Organizatorin për lëshimin me qira (në vazhdim “APLIKIMI”). Me të pranuar aplikimin, Organizatori përcakton hapësirat ekspozuese. Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data: 20 Tetor 2024. Hapësira minimale e dhënë është prej 6m² (3x2m).

5. Përcaktimi i hapësirave Me nënshkrimin e aplikimit, Ekspozuesi merr përsipër të pranojë çfarëdo zone që mund t’i caktohet, edhe nëse dimensionet e zonës janë të ndryshme nga ato që kërkohen. Organizatori mund, nëse diktohet nga planimetria e panairit, të caktojë maksimumin deri në 10% më shumë ose më pak sesa ajo e aplikuar (vetëm në raste të veçanta).

6. Konfirmimi dhe nën-qiraja e hapësirave Ndarja përfundimtare e hapësirave do të konfirmohen nga data 15 Tetor 2024 dhe janë të vlefshme vetëm për ekspozuesit e emëruar në të. Nuk lejohet asnjë nën-qira apo transferim i hapësirave, qoftë i plotë apo i pjesshëm, edhe nëse është falas.

7. Pagesa. Për çdo shërbim të ofruar, Organizatori do t’i lëshojë faturë ligjore ekspozuesit. Nëse ekspozuesi nuk e paguan faturën e plotë më së voni më 20 Tetor 2024, ai nuk do të jetë në gjendje të ekspozojë

8. Çmimet e hapësirave ekspozuese Në bazë të sektorit të biznesit që ushtron kompania ekspozuese, do të

ndahen zona ekspozuese dhe pavijonet përkatëse. Në bazë të planimetrisë llojet e standave ndahen në:

Stenda A - një anë e hapur € 50,00 për m²

Stenda B - dy anë të hapura € 75,00 për m²

Stenda C - tre anë të hapura € 100,00 për m²

Stenda D - Ishull (me katër anë të hapura) vetëm për pavijone të jashtme ose për stenda mbi 60m²

Ngritje modulare e standave (për t'iu shtuar kostos së qirasë së hapësirave):

Bazë € 25,00 për m²

E kompletuar € 50,00 për m²

Me marrëveshje, dizajn i veçantë mund të përshtatet sipas kërkesave të klientit.

Aplikimet më të hershme mund të shfrytëzojnë ofertat e mëposhtme:

-50% Për aplikimet e bëra deri më 1 Shtator 2024

-25% Për aplikimet e bëra deri më 25 Shtator 2024

Tarifat e mësipërme vlejnë për të gjithë zonën e zënë. Planimetria dhe përmasat e standave diktohen nga aplikimet dhe pagesat e pranuar për hapësirat e dhëna.

9. Depozitë Aplikimet, për të qenë të vlefshme, duhet të shoqërohen me pagesën:

Aplikimet të cilat nuk përfshijnë këtë pagesë brenda kohës së përcaktuar nuk do të merren në konsideratë dhe do të refuzohen.

Tarifa përfshin: - Listimin në katalogun zyrtar të panairit (duke përjashtuar reklammat) - Listimin në faqen zyrtare web të panairit - Një kopje falas të katalogut zyrtar të panairit dhe të materialeve të tjera promovionale ku do të shfaqet brendi i biznesit që ekspozon - Leje-kalimi zyrtar për punonjësit e kompanisë ekspozuese për gjatë ditëve të panairit - Asistencë teknike gjatë panairit për ngritjen dhe çmontimin e standave - Shërbimet e përgjithshme të sigurisë për ndërtesat dhe masat parandaluese ndaj zjarrit

10. Tërheqje nga pjesëmarrja Data e fundit për të bërë anulimin e aplikimin është: 10 Tetor 2024 Çdo kërkesë anulimi nga ekspozuesi pas kësaj date nuk merret në konsideratë dhe tarifa e regjistrimit dhe depozita nuk rimbursohen. Nëse zona e rezervuar nuk mund t'i rikaktohet një aplikanti tjetër, Ekspozuesi është

përgjegjës për shumën e plotë të përfshirë, pa të drejtë ankese.

11. Dëme të shkaktuara gjatë qëndrimit Çdo dëmtim i të mirave materiale, i shkaktuar gjatë qëndrimit në panair nga ana e Ekspozuesit, për shkak të pakujdesisë apo keqpërdorimit të tij, duhet të paguhet në mënyrë të plotë duke shtuar 20% penallti.

12. Garanci për dëmet Pranohet me këtë marrëveshje që administrata e panairit është e autorizuar të mbaje të mirat materiale të kompanisë ekspozuese, si garanci mbi pagesën e munguar.

13. Shërbimi i sigurisë dhe i ruajtjes fizike të objekteve. Organizatori do të përkujdeset për sigurinë e ruajtjes së mallrave dhe të mirave materiale të ekspozuara gjatë panairit, me shërbim sigurim të objekteve me roje fizike të jashtme, mbikëqyrje të objekteve nëpërmjet sistemeve të monitorimit gjatë ditës dhe natës për gjithë kohëzgjatjen e panairit. Organizatori nuk është përgjegjës për humbjen, vjedhjet apo dëmtimet e mallrave nga palë të treta gjatë kohës kur panairi është i hapur për publikun.

14. Pastrimi Gjatë ngritjes dhe çmontimit, pastrimi është përgjegjësi individuale e ekspozuesit. Organizatori do të përkujdeset për pastrimin e standave dhe objekteve të tjera gjatë ditëve kur panairi është i hapur.

15. Publicitet Organizatori merr përgjegjësinë të krijojë dhe të shpërndajë materiale promovionale, fushata reklamuese dhe materiale të tjera komunikimi në media (gazeta, revista, radio, tv) dhe përmes internetit dhe rrjeteve sociale për të promovuar panairin te një numër sa më i zgjeruar i njerëzve. Gjithashtu gjatë ditëve të panairit organizatori kujdeset për reklamimin e panairit për të rritur interesin e vizitorëve, me publikime të materialeve të ndryshme në internet dhe materiale të tjera promovionale. Kompanitë të cilat duan të bëhen SPONSOR zyrtar të panairit mund të kontribuojnë me shuma të ndryshme duke përfituar një vizibilitet të brendit dhe biznesit të tyre në përputhje me kontributin e tyre.

Sipas kontributit Sponsorat marrin statusin:

SPONSOR PLATINUM € 5.000 - 10.000

SPONSOR GOLD € 2.000 - 5.000

SPONSOR SILVER € 1.000 - 2.000

SPONSOR FRIEND € 500 - 1.000

16. Katalogu Zyrtar Organizatori do të kujdeset për përgatitjen dhe printimin e katalogut zyrtar ku do të jenë të përfshira të gjithë bizneset pjesëmarrëse në panair. Aplikuesit DUHET të plotësojnë formularin përkatës brenda datës 15 Tetor 2024 në mënyrë që të shmangen gabime në publikim dhe gjithashtu të sigurojnë fajlet në formatet e duhura të identitetit të brendeve të tyre për të garantuar një material shtypi cilësor.

17. Shërbime me pagesë Me pagesë shtesë të akorduar me klientin mund të përfitohen këto shërbime: - Transport dhe shërbime të tjera të përshtatura sipas nevojës - Rezervime - Sigurim i mallrave - Hostess dhe përkthyes - Shërbime fotografie dhe video - Shërbime Telefonie dhe interneti gjatë Panairit - Dhënja e sallave të konferencave dhe e auditoriumeve për takime, prezantime, workshop dhe organizime të tjera. - Menaxhim i rrjeteve sociale për ditët e panairit - Shpërndarje e materialeve promocionale - Organizim i eventeve përgjatë ditëve të panairit, të përshtatura sipas kërkesave të klientit

18. Detyrime të përgjithshme Ekspozuesit që marrin pjesë në panair duhet t'i përmbushen të gjitha detyrimeve të mëposhtme:

a) Ekspozuesi duhet të ketë ngritur dhe dekoruar plotësisht stendën të paktën 12 orë para hapjes zyrtare të Panairit.

b) Pjesëmarrësve u ndalohet të bëjnë ndërhyrje në dekorin e stendës me ri-ndërtime masive gjatë kohës kur panairi është i hapur për publikun.

c) Pjesëmarrësit duhet të lënë të dekoruar stendën e tyre me të gjithë elementet përkatëse përgjatë gjithë kohëzgjatjes së panairit. Ekspozuesit i ndalohet të tërheqë apo të çmontojnë stendën e tij deri në mbylljen zyrtare të Panairit.

d) Ekspozuesit nuk i lejohet të vendosë asgjë jashtë perimetrit të përcaktuar të stendës së tij.

e) Ekspozuesit nuk i lejohet të ketë ton të lartë audiofonie apo të krijojë zhurmë dhe ndotje të madhe akustike për të tërhequr njerëzit.

f) Ekspozuesit i ndalohet çdo formë e propagandës politike dhe fushatave me qëllim ofendues apo denigrues ndaj institucioneve social-politike.

g) Ekspozuesit e kanë të ndaluar të bëjnë reklamë për palë të treta të cilat nuk janë të pranishme në hapësirat e panairit.

h) Ekspozuesit duhet të tërheqin të gjitha mallrat dhe të çmontojnë stendën brenda 10 (dhjetë) ditësh pas mbylljes së panairit. Organizatori nuk mban përgjegjësi për mallrat e munguara pas kësaj date.

19. Rast i caktuar Mos respektimi i rregullave në pikat e mësipërme shkakton anulimin e kontrates dhe mbylljen e menjëhershme të stendës pa kompensim.

20. Ngritja dhe dekorimi i Stendave - Çdo ekspozues duhet të dorëzojë, për aprovim paraprak, planin dhe dekorin e stendës duke përfshirë planin e instalimit të ndriçimit dhe pajisjeve të tjera që kërkojnë instalim elektrik. Elementet nuk mund të jenë më të larta se 4 (katër) metra nga toka. Organizatori mund të ndryshojë kufirin e lartpërmendur për raste të veçanta në marrëveshje dhe vënje në dijeni në kohë të klientit. - Në hapësirat e dhëna, ekspozuesit nuk mund të instalojnë mobilime dhe objekte të cilat mund të pengojnë ndriçimin apo t'i dëmtojë në mënyra të ndryshme ekspozuesit e tjerë. - Organizatori mban të drejtën të intervenojë me stafin e tij dhe t'i faturojë ekspozuesit shpenzimet përkatëse të heqjes apo modifikimit të instalacioneve të cilat: mund të dëmtojnë apo të shëmtojnë pamjen e pavijoneve, bezdisin vizitorët dhe ekspozuesit e tjerë, janë instaluar pa aprovimin e organizatorit apo në mosrespektim të pikës në vazhdim. - Në çdo rast ekspozuesi mbetet pala e vetme përgjegjëse për çdo gjë që ka të bëjë me ngritjen e stendës së tij në zonën që i është caktuar dhe dëmeve që mund të lindin, si ndaj Organizatorit edhe ndaj palëve të treta; Ekspozuesi ka përgjegjësi të dëmshpërblejë cilëndo palë për çdo dëmtim të shkaktuar prej tij. - Për ngritjen e stendës Ekspozuesi duhet t'i përmbahet të gjitha rregullave të vendosura të sigurisë dhe masave parandaluese kundër zjarrit sipas standardeve më të fundit. Formulari përkatës i sigurisë do të nënshkruhet nga Ekspozuesi para transportimit të mallrave dhe origjinali e saj duhet të mbahet fizikisht te stenda e tij. - Hyrja e automjeteve brenda pavijoneve është rreptësisht e ndaluar përveç nëse autorizohet nga organizatori si përjashtim. Në këtë rast, aplikanti duhet të garantojë që gazi i shkarkimit të emetohet jashtë nëpërmjet tubacioneve ose mjeteve të tjera të përshtatshme teknike. Automjetet elektrike përbëjnë përjashtim. - Ekspozuesi nuk mund të alterojë apo të ndryshojë standet e ngritura nga Organizatori, as të

forcojë hapjen e dyerve apo sendeve të kyçura, të bëjë vrima apo të lyejë, asgjë, pa aprovimin e Organizatorit. - Në rast të ndryshimeve, alterimeve apo dëmtimeve të sendeve të vëna në dispozicion nga Organizatori, të konstatuara nga stafi, Ekspozuesit do t'i faturohet kostoja e restaurimit përkatës pa paragjykuar dëme të mëtejme. - Brenda pavijoneve dallohet përdorimi i sharrave cirkularë, mullinjve apo mjeteve të ndryshme të cilat nuk kanë mekanizmat e përshtatshëm të filtrimit nga pluhurat dhe ashklat. Stenda e cila pa arsye të justifikuar: a. nuk është ngritur dhe dekoruar në mënyrë të pranueshme dhe nuk ka shenjë dalluese të biznesit, nuk ka produktet e ekspozuara, nuk është liruar nga ambalazhimet apo materiale të tjera që nuk do të përdoren për panairin; Dëmton vizualisht pavijonin b. është lënë pa mbikëqyrje apo dukshëm pas dore gjatë panairit; mund të konsiderohet, sipas gjykimit të organizatorit, të jetë e braktisur dhe për këtë arsye ky i fundit mund të bëjë lirshëm marrëveshje të re. Në atë rast, ekspozuesi, pa marrë parasysh pagesën e hapësirës përkatëse, detyrohet të paguajë penallti të barasvlershme me dyfishin e tarifën e pjesëmarrjes. Pas hapjes së panairit, nuk do të lejohet hyrja ose dalja e mallrave, përveç rasteve të jashtëzakonshme të autorizuara më parë nga organizatori.

21. Kërkesa dhe ankesa Çdo kërkesë, ankesë apo pyetje që mund të lind duhet të drejtohet Organizatorit në formë të shkruar. Bazuar në këtë dokument deklaroj se kam pranuar kushtet dhe rregullat në këtë marrëveshje dhe po nënshkruaj me vullnetin tim të plotë.

Aplikanti:

Emër:

Mbiemër:

Firmë

Organizatori:

Emër: **Mark**


Mbiemër: **Culaj**

Firmë

Data:



Pamja e përfërt e standës



Pozicioni ne sallë